



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 05.**

Prishtinë, më 7.06.2011 në ora 13

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živković, Jelena Bontić, Petar Miletić, Mufera Sinik Rasim Demiri dhe Etem Arifi .

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: OSC-së -këshilltare e Institutit të Avokatit të Popullit Jerina Dompier, përfaqësuese e Institutit të Avokatit të Popullit Radiq Dragana, Tafil Rrahmani, përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuesit nga KDI Kastriot Shala, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, zëvendëskryetare e parë të Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare, me raportin e Komisionit funksionale - Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/ L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/ L-069 për Akreditim, me raportin e Komisionit funksionale - Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, në cilësinë e Komisionit funksional.
6. Shqyrtimi i listës së ekspertëve për fushën e të Drejtave të Njeriut, Komuniteteve dhe Barazisë Gjinore.
7. Shqyrtimi i shkresave të Ombudspersonit me ankesa nr. 04/403/ Do-215 të datës 20.05.2011.
8. Të ndryshme

Myzejene Selmani - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar 27.04.2011

Kryesuesja – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 27.04.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare, me raportin e Komisionit funksionale - Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare të propozuara nga Komisioni Funksional. Kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. . Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/ L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/ L-069 për Akreditim, me raportin e Komisionit funksionale - Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesja, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/ L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/ L-069 për Akreditim, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të perkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/ L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/ L-069 për Akreditim, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, në cilësinë e Komisionit funksional.

Kryesuesja- theksoi se javën e kaluar Projektligji nr.04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, është miratuar në Kuvend në parim.

Ajo propozoi që për amandamentim të Projektligjit, në cilësinë e komisionit funksional do të formojmë nënkomision, dhe se do të përzgjidhet nga një anëtare që përfaqëson komunitetin e vet.

Albert Kinolli- tha se Komisioni për Komunitete dhe Kthim është në përbërje të të gjitha komuniteteve që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre. Pajtohet se në grup

punues duhet të përcaktohet nga një përfaqësues të secilit komunitet. Ai shtoi se do jemi unik gjatë punës së amandamentimit të Projektligjit.

Kryesuesja- konstatoi se në bazë të diskutimeve të anëtarëve të komisionit u mor qëndrim që të formohet nënkomision. Në listën e anëtarëve të nënkomisionit, kryesueses u emërua Albert Kinolli, përfaqësues tjerë: Lirije Kajtazi, Myfera Sinik, Rasim Demiri, Jelena Bontic dhe Etem Arifi. Formulimi i saktë i amandamenteve sërish do të shqyrtohet në komision ku do të paraqesim rekomandime të cilat do të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i listës së ekspertëve për fushën e të Drejtave të Njeriut, Komuniteteve dhe Barazisë Gjinore.

Kryesuesja - paraqiti lista e eksperteve të propozuara nga përfaqësuesit e NDI-së dhe organizatave të tjera që të ofrojë Komisionit përkrahje në promovimin e të drejtave të komuniteteve. Pasi nuk kishte propozime tjera Komisioni unanimisht miratoi listën e ekspertëve për fushën e të Drejtave të Njeriut, Komuniteteve dhe Barazisë Gjinore

7. Shqyrtimi i shkresave të Ombudspersonit me ankesa nr. 04/403/ Do-215 të datës 20.05.2011.

Kryesuesja – konstatoi se Komisioni për Komunitete dhe Kthim në mbledhjen e mbajtur me 7.06.2011 i shqyrtoi në parim ankesat e Institucionit të Avokatit të Popullit nr. 04/403/Do-215 të datës 20.05 2011, dhe ka vendosur të nxjerr këtë:

P ë r f u n d i m

1. Ankesat e Institucionit të Avokatit të Popullit nr. 252/2010, 265/2010, 267/2010 dhe 277/2010, për shkak se nuk është kompetente ia dërgon në shqyrtim komisionit kompetent parlamentar, Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione për procedim të mëtejshëm.
2. I rekomandohet komisionit kompetent që të merr parasysh përfundimin përkritazi me të njëjtat ankesa dhe të veproj në përputhje me kompetencat e saja, në bazë të nenit 25 e 26 të Ligjit për Institucionin e Avokatit të Popullit.

8. Të ndryshme

Myfera Sinik- në fjalinë e saj tha se një familja e komunitetit turke që jeton në Prishtinë, ka probleme dhe para disa ditë ka paraqitur kërkesë me shkrim. Prandaj si përfaqësuese e këtij komuniteti kam obligim dhe detyrë të parashtroj çështjet e komunitetit tonë dhe kërkoj që të gjendet zgjidhje adekuate.

Kryesuesja - mendon se secili qytetare që ka probleme, ato mundet të parashtron tek institucionet përkatëse që marrin me këto çështje, siç janë SHPK, FSK etj.

Ajo propozoi që Komisioni shkresa në fjalë duhet të adresojë Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione, për procedim të mëtejshëm.

Albert Kinolli - foli lidhur me gjendjen e jetesës së bashkësisë RAE në komunën e Obiliqit. Ky problem rrjedh prej momentit të marrjes së informatës, në ndërtesa N. 1 me datë 31.12.2010, është djegur kulmi i banesës në tërësi, ndërsa deri sot Institucionet tona lidhur me këtë çështje kanë bërë shumë pakë

Me këtë rast është marr Ministria e Punëve të Brendshme, UNHCR, Kryqi Kuq dhe KFOR-i. Pas tjerash UNHCR, Kryqi i Kuq kanë asistuar në mobilizim të situatës duke ofruar gjëra të nevojshme për këta banorë. Tani një numër i madh i tyre jetojnë në tenda pasi që banesa paraqet rrezik për jetesë.

Ai propozoi që Komisioni të formojë një grup punues dhe në afat sa më të shkurtër të vizitohen përfaqësuesit e këtyre komunitete, që të njihemi me gjendjen reale sa i përket banimit. Njëherit kërkoi që Komisioni të përsërisë shkresën dhe ti dërgohet Ministrive përkatëse.

Etem Arifi – sa i përket situatës së banorëve në Komunën e Obiliqit gjendja nuk është reale sepse në kërkesën tonë është përgjigj vetëm Ministria e Administratës Publike ndërsa resurset tjera jo. Theksoi se për tejkalim të kësaj situatë, Komisioni duhet sa më parë të vizitoi Komunën e Obiliqit që të njihemi për së afërmi me gjendjen reale të këtyre banorëve.

Në këtë drejtim Komisioni mund të kërkojë informacione shtesë nga Komuna e Obiliqit dhe nga Institucionet përkatëse.

Agim Kuleta – Sa i përket informatës në lidhje me vizitën që do të bëhen lokalitetit në Obiliq, kemi shpresuar se do të marrim pasqyrë reale sa i përket banorëve të ndërtesës Nr. 1.. Pra problemi qëndron kryesisht pse ende nuk është ndërtuar kulmi në këtë ndërtesë.

Në bazë të informatës me të dhëna nga Komuna e Obiliqit, shihet se ka pavërtetësi. Ai kërkoi se lidhur me vizitën në Komunën e Obiliqit, Komisioni duhet të dalë me një raport përfundimtar.

Lumnije- pajtohet se kemi informatës se pas shpërthimit të zjarrit është djegur kulmi i banesës nr.1 në Komunën e Obiliqit dhe se për këtë çështje duhet të merren Institucionet e Kosovës.

Ajo theksoi se përderisa ka ekspert dhe në bazë të vërtetimeve të tyre kjo ndërtesë i plotëson kushtet për banim. Andaj mendon se Komisionit nuk është kompetent që të shkojë në cilësinë e ekspertëve dhe të bëjë vërtetësinë se i plotëson apo jo kushtet për banim.

Myzejene Salmanaj- ajo kërkoi që lidhur me situatën e krijuar në Komunën e Obiliqit, Komisioni do të drejtohet ekzekutivit të cilët janë përgjegjës që të raportojnë në Kuvend.

Kryesuesja– konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2011 dhe me kërkesën e vet për dërgimin e informatave për gjendjen dhe kushtet jetësore të pjesëtarëve RAE në Plemetin pas shpërthimit të zjarrit, shqyrtoi Njoftimin p.n. të datës 01.06.2011 të Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Komunës së Obiliqit dhe vendosi të paraqesë këtë.

R e k o m a n d i m

1. Rekomandohet që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim dhe koordinim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Ministrinë për Komunitete e Kthim dhe Zyrën për komunitete pranë Zyrës së Kryeministrit, në mënyrë urgjente të ndërmarrin dhe të zbatojnë të gjitha masat për sanimin e pjesës së objektit banesor të përfshirë nga zjarri dhe me qëllim të sanimit dhe eliminimit të gjendjes së shkaktuar dhe sigurimin e kushteve elementare për jetë dhe banim të pjesëtarëve të komunitetit RAE.
2. Është e domosdoshme që të pranohen, të përkrahen dhe sa më shpejtë të zbatohen masat e nevojshme ashtu siç rekomandohet, sepse gjendja e komunitetit është alarmuese, dhe në lidhje me shkallën e përparimit në relacionin e këtij projekti t'i raportohet Komisionit.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëeskryesuesja e parë e Komisionit

Mujejene Selmani